



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:009305

Datë: 05.12.2018

Numri i dokumentit: 00183041

**P. nr.249/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. R. nga fsh.B. i B., K-Gjakovë, për shkak të veprave penale lejimi njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP/II.nr.410/18 të dt.23.03.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **16.11.2018**, në prani të Prokurorit së shtetit Bajram Kryeziu, si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **I. R.** nga fsh. B. B. K Gjakovë, data e lindjes ... i biri i N. dhe i nënës Sh. e gjinisë K., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, martuar atë i 1 fëmijëve, ID ....

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

- **I.** me datë 10.11.2017, në shtëpinë e tij në fshatin B. i B., Komuna e Gjakovës, ka shmangur njësorin elektrik i cili gjendej në pronën e cila është në posedimin e tij, në atë mënyre që gjatë kontrollimit nga punëtorët e K.-it në Gjakovë, i pandehuri nuk e ka dorëzuar njësorin elektrik me numër ... edhe pse punëtorët e kanë qenë të obliguar të bëjnë leximin e njësorit dhe të e dërgojnë në qendrën e kalibrimit.

**-me çka ka kryer veprën penale lejimi njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324/1 të KPRK-së**

**II.** Nga data e pa vërtetuar e gjerë me datë **20.12.2017**, në shtëpinë e tij në fshatin B. B., Komuna e Gjakovës, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 par.1 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, në atë mënyrë që jashtë njësorit elektrik me numër ..., përmes kabllor të cilën e ka vendosur në murin e shtëpisë është lidhur direkt në rrjetin elektrik, kështu ka penguar regjistrimin e energjisë

elektrike të shpenzuar, me ç' rast të dëmtuarës K.-Divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 67.51 euro.

**-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73, neni 324/1 dhe neni 320 të KPRK-së dhe neni 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

- Për veprën penale të përshkruar në pikën I-rë të dispozitivit të këtij Aktgjykimi lejimi njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324/1 të KPRK-së ,dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 2 (dy) muajve** si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

**II.** - Për veprën penale të përshkruar në pikën II-të të dispozitivit të këtij Aktgjykimi vjedhje e shërbimeve komunale neni 320 të KPRK-ës, dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 2 (dy) muajve** si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

**Gjykata bazuar në nenin 80 të KPRK-së i shqipton :**

Dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara K.-Distrikti në Gjakovë , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet gjyqësore të përcaktuara nga gjykata si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **20.00 euro**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën, PP/II.nr.410/18 të dt.23.03.2018, e ka akuzuar të akuzuarin I. R. nga fsh. B. i B., K Gjakovë, për shkak të veprave penale lejimi njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324/1 të KPRK-së dhe veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, në shqyrtimin fillestar me dt.16.11.2018, lexon aktakuzën PP/II.nr.410/18 të dt.23.03.2018 dhe deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari I. R. gjatë shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjendje e tillë është konstatuar nga punëtorët e K.-it ,shtojës se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprat e kryer mirëpo nuk qëndron fakti se unë i kam ndaluar të marrin njehsorin por ditën kritike ata përmes telefonit kanë kontaktuar me mua Me pranimin e fajësisë jam penduar për veprat të kryera të cilat i

kam bere për shkak te kushteve te dobëta ekonomike me qe jam i pa punë dhe jetojë ne barake me gruan dhe djalin 1 vjeçar andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimin te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes dhe i propozoi gjykatës qe i njëjti te shpallet fajtor te dënohet sipas ligjit po ashtu i njëjti te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale ndërsa e dëmtuara te udhëzohet ne kontest civil.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari J. R. : I. me datë ...., në shtëpinë e tij në fshatin B. i B., Komuna e Gjakovës, ka shmangur një sorin elektrik i cili gjendej në pronën e cila është në posedimin e tij, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga punëtorët e K.-it në Gjakovë, i pandehuri nuk e ka dorëzuar një sorin elektrik me numër ... edhe pse punëtorët e kanë qenë të obliguar të bëjnë leximin e një sorit dhe të e dërgojnë në qendrën e kalibrimit. II. Nga data e pa vërtetuar e gjerë me datë 20.12.2017, në shtëpinë e tij në fshatin B. B., Komuna e Gjakovës, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 par.1 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, në atë mënyrë që jashtë një sorit elektrik me numër 32603375, përmes kabllos të cilën e ka vendosur në murin e shtëpisë është lidhur direkt në rrjetin elektrik, kështu ka penguar regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar, me ç' rast të dëmtuarës K.-Divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 67.51 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimin te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se jeton në barakë me gruan dhe djalin 1 vjeçar, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij për veprën e kryer, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej veprat e tilla, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se i akuzuari më parë nuk ka qene i dënuar, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim unik me burg ne kohëzgjatje prej 3(tre) muajve dhe dënim me gjobë prej 200.00(dyqind) euro të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin prej 1(një) viti te mos kryej ndonjë vepër tjetër penale,

me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.249/18 më datë 16.11.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.